




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE	
SKENDERAJ	
Nr.	
No.	03-112/01-0052629/24
Data.	
Data.	18. 11. 2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Sk

Drejtoria e administratës

SEKTORI PËR INTEGRIME EVROPIANE

DREJTAVE TË NJERIUT DHE BARAZISË GJINORE

Plani i Punës -2025

Plani i Punës i sektorit për Integritim Evropian, Drejtave të Njeriut dhe Barazisë Gjinore, mbi aktivitetet në sferat e integritimit të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore do të vazhdojë bashkëpunimin me strukturat e nivelit lokal për të promovuar avancuar dhe mbrojtur ato.

Sektori i IEDNJBZ do të organizoj takime që kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes për avancimin e të drejtave për të gjithë, integritim, pa lënë anash këshillimet dhe udhëzimet e organeve komunale për respektimin e të drejtave të njeriut në aspektin e barazisë gjinore, e të drejtave të fëmijëve, të drejtave të personave me aftësi të kufizuar e tjerë, si dhe do të monitorohen aktivitetet e komunës ,asambleja komunale etj.

Në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, të ofrojë mbështetje në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe planeve lokale për promovimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen nga diskriminimi në komunën përkatëse, promovimin e praktikave e mira dhe ndihmën në ngritjen e kapaciteteve të komunës për të parandaluar dhe luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë në zbatimin e funksioneve të saj

Në koordinim të ngushtë me strukturat tjera organizative që veprojnë në kuadër të Komunës, promovon mbrojtjen nga diskriminimi në të gjitha politikat/ dhe funksionet e Komunës

Bashkëpunimin me Avokatin e Popullit në sigurimin e zbatimit të legjislacionit dhe të çdo rekomandimi për komunën, Informimin dhe udhëzimin në formën verbale apo të shkruar për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje për të gjithë punonjësit dhe personat që pretendojnë që janë të diskriminuar

Realizimin e aktiviteteve vetëdijesuese mbi mos-diskriminimin në institucionet publike, shëndetësore dhe arsimore, si dhe raportimin në baza periodike tek mbikqyrësi i drejtëpërdrejtë dhe tek niveli qendror.

Mbështetje financiare për projektet të OJQ-ve, në promovimin " të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, barazi gjinore etj.

- Monitorimi dhe zbatimi i ligjit për barazi gjinore, takime të rregullta me komisione për rregullore, vlerësimin e situatës aktuale sa i përket barazisë gjinore etj.

-Hulumtim më qytetar për buxhetin e përgjegjshëm gjinor, trajnimet "Buxheti dhe analiza sensitive gjinore".

-Koordinimi dhe ndërveprim i mirë institucional në luftë kundër fenomenit të dhunës në familje ,në parandalim mbrojtje dhe rehabilitim të viktimës.

-Avokim me strukturën komunale për vendosjen në banesa Sociale rastet ekstreme të dhunës në familje.

-Ngritja e kapaciteteve me qëllim të integritit gjinor në politika publike në nivelin Komunal

-Vazhdimi i masës afirmative për regjistrim falas të pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve

-Përkujdesja për fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe strehimi i tyre,

-Trajtimi për fëmijët që kërkojnë lëmoshë, dhe që punojnë në rrugë veçanërisht të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

-Krijimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe programeve për parandalimin dhe ri-integrimin e fëmijëve të abuzimit me drogën.

-Shënimi i 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas.

-Shënimi i Ditës ndërkombëtare për personat me aftësi të kufizuar 03.Dhjetori ,në bashkëpunim me OJQ.

-Shënimi i 25 Nëntorit- Dita Ndërkombëtare për eliminimin e Dhunës ndaj Gruas.

-Shënimi i 10 Dhjetorit – Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.

-Organizimi i Festës së 1 Qershorit-Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve.

-Pjesëmarrja në trajnime të ndryshme ,si dhe bashkëpunimi me media.

-Organizimi i fushatave vetëdijesuese për të drejtën në trashëgimi

-Verifikimi i rasteve të nxënësve të cilët nga mungesa socio/ekonomike kanë braktisur shkollimin mundësisht tu dilet ne ndihmë financiare(sigurimin e biletave të autobusit etj.)


Nr	Qëllimi i përgjithshëm	Aktiviteti	Stafi përgjegjës	Afati
1.	Vizita në shkollat fillore, dhe qerdhet		NJMDNJ - Zyra për Barazi gjinore	Janar

2.	Vizita në shkollat e mesme	Dhuna në shkolla dhe braktisja e nxënësve.	NJMDNJ - Zyra për Barazi gjinore	Shkurt
3.	Aktivitete vetëdijesuese në shkolla kundër diskriminimit 1 Mars Shënimi I 8-të marsit Dita Ndërkombëtare e Gruas		NJMDNJ - Zyra për Barazi gjinore NJMDNJ - Zyra për Barazi gjinore	Mars
4.	18 prilli dita ndërkombëtare kundër braktisjes së fëmijëve	Aktivitete të ndryshme , broshura tryeza debate	NJMDNJ - Zyra për Barazi gjinore	Prill
5.	Takime me këshillat e fshatrave		NJMDNJ - Zyra për Barazi gjinore	Maj
6.	1 Qershori dita e fëmijëve	Aktivitete të ndryshme	NJMDNJ - Zyra për Barazi gjinore, Drejtoria e Arsimit	Qershor
7.	Ekskursion me shoqatën HANDYIKOS	Koordinim me shoqatën HANDIKOS rreth organizimit	NJMDNJ - Zyra për Barazi gjinore	Korrik
8.	-Tetori, muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit. -Fushata vetëdijesuese në parandalimin e trafikimit me njerëz	- Aktivitete të ndryshme , broshura tryeza debate - Aktivitete të ndryshme , broshura tryeza debate(18 tetor - 18 nëntor)	NJMDNJ - Zyra për Barazi gjinore, OJQ, Policia e Kosovës, Qendra për punë sociale etj.	Tetor
9.	Fushata vetëdijesuese në parandalimin e trafikimit me njerëz. 25 nëntor, dita kundër dhunës në familje	- Aktivitete të ndryshme , broshura tryeza debate(18 tetor - 18 nëntor) Shënim i ditës ndërkombëtare kundër	NJMDNJ - Zyra për Barazi gjinore, OJQ,	Nëntor Nëntor

		dhunës në familje (16-të ditë aktivizim)	Policia e Kosovës, Qendra për punë sociale etj.	
10.	-Dita ndërkombëtare e personave me aftësi të kufizuara. -10-të dhjetori dita ndërkombëtare për të drejtave të njeriut	Organizimi i takimeve me këtë kategori -Aktivitete të ndryshme , broshura tryeza debate	-NJMDNJ - Zyra për Barazi gjinore, Drejtoria e Arsimit -NJMDNJ - Zyra për Barazi gjinore, OJQ, Policia e Kosovës, Qendra për punë sociale etj.	Dhjetor

Udhëheqësja e Sektorit

Mirjeta Rukolli



Skenderaj

18.11.2024